



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 15 qershor 2015

Numri i lëndës: 2014-38

Slavica Mikic

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 15 qershor 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 30 shtator 2014.

II. FAKTET

2. Më 3 dhjetor 2010, në Gjakovë, i biri i ankueses, A.B., ishte qëlluar nga A.K., zyrtar i policisë së Kosovës. A.B. kishte marrë trajtim mjekësor në një spital në Beograd, por kishte vdekur nga plagët e tij më 27 dhjetor 2010.
3. Më 5 dhjetor 2012, një prokuror i EULEX-it nga zyra e prokurorisë të EULEX-it në Pejë kishte nisur një hetim ndaj A.K. mbi dyshimin për vrasjen e të birit të ankueses.
4. Më 3 qershor 2011, prokurori i EULEX-it kishte përfunduar hetimet. Ai ka gjetur se A.K. kishte vepruar në vetëmbrojtje, pasi A.B. e kishte kërcënuar atë për ta vrarë duke ia drejtuar pistoletën në drejtim të tij.

III. ANKESAT

5. Pa u thirrur në ndonjë instrument të veçantë ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ankuesja pohon se rrethanat e vdekjes së birit të saj nuk janë hetuar siç duhet dhe kryesi nuk është sjellë para drejtësisë.

IV. LIGJI

6. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
7. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
9. Paneli vëren se ankesa e ankueses ka të bëjë me përfundimin e procedurës penale ndaj personit që ka vrarë të birin e saj. Vendimi përfundimtar në këto procedura ishte dhënë më 3 qershor 2011, kur prokurori i EULEX-it kishte përfunduar hetimet në këtë lëndë. Ankesa

në Panel ishte parashtruar më 30 shtator 2014, jashtë afatit gjashtëmujor të parashikuar me rregullën 25, paragrafi 3 i rregullores së punës. Rezulton se ankesa nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me rregullën 29 të rregullores së punës së Panelit.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri, konstaton se ankesa duhet të refuzohet në përputhje me rregullën 28 (c), pasi që ajo që është parashtruar jashtë afatit, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese